



Ambassade de France au Kosovo

PROTOKOL MARRËVESHJE

për

Orët e financuara nga Ambasada e Francës në Kosovë

për seancën e pranverës 2014

në dobi të diplomatëve të regjistruar në Akademinë Diplomatike të Kosovës

Në mes :

Ambasadës së Francës në Kosovë, e vendosur në rrugën Qemali Ismail nr 67, 10000 Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Ambasadorja Zonja Maryse DAVIET,

dhe

Akademisë Diplomatike të Kosovës, e vendosur në rrugën Luan Haradinaj, 10000 Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Drejtori, Ambasadori Skender DURMISHI,

Është rënë dakord si më poshtë :

Neni 1 : Ambasada e Francës organizon një seancë të kursit të gjuhës frënge të nivelit A1 të Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët, për një grup prej 8 pjesëmarrësish, ne bazë të pjesëmarrjes ne sesionin e parë, organizuar nga tetori 2013 deri në janar 2014.

Neni 2 : Grupi përbëhet nga 8 pjesëmarrës , me propozimin e Akademisë Diplomatike të Kosovës.

Neni 3 : Seanca, plotësisht e financuar nga Ambasada , do të përfshijë kurse një herë në javë nga 1 orë 30 minuta për një periudhë prej 13 javësh nga 31 mars deri më 24 qershor ,ose në përgjithësi 13 orë mësimi .

Neni 4 : Kursi korrespondon në nivelin A1 të Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (CECR), që do të thotë, niveli fillestar. Neni 5 : Kursi do të mbahet në ambientet e Akademisë Diplomatike të Kosovës, në rrugën Luan Haradinaj, 10000, Prishtinë, Kosovë.

Neni 6 : Kursi do të mbahet nga një mësimdhënëse gjuha amtare e të cilës është frëngjishtja.

Neni 7 : Materiali pedagogjik do të ofrohet nga Ambasada e Francës në Kosovë.

Neni 8: Akademia Diplomatike e Kosovës angazhohet të sigurojë një klasë të pajisur me një CD player dhe një tabelë të bardhë.

Neni 9 : Pjesëmarrësit e regjistruar angazhohen, nën mbikëqyrjen e Akademisë Diplomatike të Kosovës të jenë të pranishëm gjatë të paktën 10 orë të mësimit gjatë tërë seancës.

Neni 10: Në rast të mungesës së një pjesëmarrësi në 6 orë të mësimit, Ambasada e Francës rezervon të drejtën e anulimit të regjistrimit të tij.

Neni 11: Një certifikatë e kurseve të përfunduara do ti ipet çdo pjesëmarrësi në fund të seancës së kursit.

Neni 12: Ky Protokol Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit dhe do të përfundojë në fund të sesionit 2014.

Neni 13: Ky protokol nënshkruhet në katër kopje origjinale, dy në gjuhë frënge dhe dy në gjuhën shqipe.

Prishtinë më 25 mars 2014


Për Ambasadën e Francës në Prishtinë



Maryse DAVIET

Ambasadore

Për Akademinë Diplomatike



Skender DURMISHI

Drejtor